


Albanian

Manuali i Punëtorëve migrues



Informacion dhe Shërbime



South Hams
District Council

Mirë se vini në South Hams-in e bukur, në Devon-in Jugor



© Crown Copyright.
All rights reserved.
South Hams District
Council. Licence No.
100022628/ 2007

Ky manual përmban informacion të dobishëm rreth jetës dhe punës, për njerëzit që shpërngulen nga jashtë ose nga ndonjë tjetër zonë në Mbretërinë e Bashkuar. Kontributi juaj në komunitetin tonë është jashtëzakonisht i vlefshëm dhe ne ju dëshirojmë një qëndrim të sigurt dhe të kënaqshëm gjatë vizitës tuaj në Devon.

Falënderimet: Ky libër ishte një projekt i përbashkët në bashkëpunim me South Hams District Council - Këshillin e Qarkut të South Hams-it, CVS-in e South Hams-it dhe është mbështetur nga CAB i South Hams-it. Është financuar nga Centrica.

MOSPRANIM: Përderisa është ndërmarrë një kujdes i veçantë për tu siguruar se informacioni që përmban ky libër është i saktë, ju këshilloheni që të kontaktoni agjencitë përkatëse të radhitura sipas shërbimeve të tyre aktuale, sepse rrethanat mund të ndryshojnë.

Tetor 2007

Përmbajtja

Punësimi dhe Financat

Skema për Regjistrimin e Punëtorëve (SRP)	4
Gjetja e punës	5
Taksa për Të Ardhurat dhe Sigurimi Kombëtar	6
Të drejtat për Punësim	7
Legjislacioni i Shëndetit & Sigurisë	8
Përfitimet Shtetërore	8
Paratë dhe Veprimet bankare	8

Shërbime Urgjence

Policia	10
Krimi	11
Siguria juaj	13
Siguria publike	14
Siguria personale	15
Zjarri	15

Strehimi dhe Akomodimi

Informata të përgjithshme	17
Strehimi tek qiraxhinjtë privat	17
Shtëpitë për Banim të Përbashkët (ShBP)	18

Shëndeti dhe Mirëqenia

Trajtim në urgjencë	19
Spitale	20
Mjekët e përgjithshëm	20
Shërbime dentare	21
Farmacitë	21
Optikat	21

Arsimi dhe Kualifikimi

Shkollat	22
Mësim për bashkësinë dhe të rriturit	22

Shërbimet Lokale

Shërbimet e Këshillit dhe Numrat e Kontaktit	23
Shërbimet e bibliotekës, përfshirë edhe lidhje interneti	23
Feja dhe Besimi	23
Kultura dhe koha e lirë	24
Zyra për këshillimin e qytetarëve	24
Shërbime të komunitetit	25
Vullnetarizmi	25
Agjencione tjera që mund të ndihmojnë	26

Punësimi dhe financat



Nëse jeni qytetar britanik ose shtetas i Zonës Ekonomike Europiane (ZEE) nuk ju duhet leje për të punuar në Mbretërinë e Bashkuar.

Shtetasit e tetë shteteve që janë anëtarë të rinj të Bashkimit Europian (Polonia, Lituania, Estonia, Latvia, Sllovenia, Sllovakia, Hungaria dhe Republika Çeke) të cilët janë të punësuar duhet të regjistrohen në Skemën për Regjistrimin e Punëtorëve. Nëse jeni nga një nga këto shtete të reja anëtare dhe do të vetë-punësoheni, atëherë nuk keni nevojë që të regjistroheni në këtë skemë!

Nëse vendi juaj nuk bën pjesë në ZEE, ju ende keni mundësi të punoni në Mbretërinë e Bashkuar nëse jeni i përshtatshëm për të marrë Lejen e Punës ose plotësoni kriteret që janë të vendosura në një nga skemat në dispozicion të njerëzve që dëshirojnë të vijnë në MB. Pasaporta juaj do të vulozet me qëllim që të tregohet nëse jeni të lejuar që të punoni këtu.

Për informacione të mëtejshme drejtoheni tek:

www.workingintheuk.gov.uk

Ose telefononi: **0870 606 7766**

Skema për regjistrimin e punëtorëve (SRP)

Regjistrimi në këtë skemë është i nevojshëm nëse ju jeni shtetas i një prej shteteve të reja të BE-se. Është e domosdoshme që të aplikoni për regjistrim jo më larg se një muaji para fillimit të punës në MB. Për t'u regjistruar, ju duhet të plotësoni dhe të dërgoni Formën e Aplikimit të SPR-së.

Kjo mund të gjendet tek: www.workingintheuk.gov.uk

Ose telefononi **Zyrën Qendrore** në: **0870 521 0224**

Nëse punoni në mënyre të legalizuar në MB për 12 muaj rresht pa ndërprerje, atëherë do të keni të drejtat e plota për lëvizje të lirë dhe nuk do keni më nevojë të regjistroheni në Skemën për Regjistrimin e Punëtorëve. Ju pastaj mund ta merrni lejen për vendbanim që e konfirmon të drejtën tënde për të jetuar dhe punuar në MB. Nëse jeni të regjistruar në Skemën për Regjistrimin e Punëtorëve dhe njëkohësisht keni punuar gjatë kësaj kohe në MB prej 12 muajsh, ju tani keni mundësinë të aplikoni për lejen për vendbanim.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të **Drejtorisë për Imigrimin dhe Nënshitetësinë** www.ind.homeoffice.gov.uk

Nëse ju duhen informacione të mëtejshme, telefononi **Zyrën e të Dhënave për Imigrimin dhe Nënshitetësinë** në: **0870 606 7766**

Punëdhënësit janë duke shkelur ligjin, nëse ju kane marrë në punë, pa qenë të regjistruar për të punuar.

Gjetja e punës

Mundësitë për punësim mund të gjenden nëpërmjet shumë burimeve:

- Gazetave lokale
- Agjencie private të punësimit
- Nga bisedat me shokë
- Duke vizituar zyrën qeveritare “Jobcenter Plus”

Jobcenter Plus është një agjenci qeveritare që mbështet në punë personat në moshë pune dhe që ndihmon punëdhënësit të plotësojnë vendet e lira të punës. Ju mund ta vizitoni qendrën tuaj lokale të punës ose zyrën e Jobcentre Plus. Ju mund ta gjeni adresën dhe telefonin e zyrës lokale tek biblioteka lokale dhe zyrat e këshillit.

Jobcentre Plus: www.jobcentreplus.gov.uk

Për informacione të mëtejshme drejtohuni tek:
www.workingintheuk.gov.uk

Departamenti i Punës dhe Pensioneve: www.dwp.gov.uk

Ose telefononi në: **0207 712 2171**

Tatimi mbi të ardhurat

Nëse jeni i punësuar, Tatimi mbi të Ardhurat do t'ju zbritet direkt nga paga. Kjo quhet paguaj ndersa fiton (PNF). Për qëllime tatimore, ju do të trajtoheni si rezident i MB-së nëse:

- Ju keni qëndruar në MB per 183 ditë ose më shumë gjatë vitit financiar, ose
- Ju e vizitoni MB rregullisht dhe koha mesatare e qëndrimit tuaj ne MB është 91 ditë apo më shumë të një viti financiar gjatë një periudhe që nuk i kalon 4 vjet, ose
- Ju vini në MB, me qëllim që të qëndroni më së paku 2 vjet

Viti fiskal/financiar llogaritet prej 6 Prillit deri me 5 Prill. Të gjitha vendet e BE-së kanë marrëveshje mes njëri-tjetrit, kështu që ju nuk do të tatoheni dy herë për të njëjtat të ardhura.

Normat e zbritjes mund të gjenden në faqen e internetit të **HM të Ardhurat dhe Dogana**: www.hmrc.gov.uk/rates/index.htm

Ju mund të fitoni një shumë të caktuar të të ardhurave gjatë vitit financiar pa paguar tatimin mbi të ardhurat. Këto janë të ardhurat tuaja personale, te cilat janë të lira nga taksat. Ju do të njoftoheni për shumën që ju takon nga HM të Ardhurat Vjetore dhe Dogana. Nëse të ardhurat tuaja nuk e kalojnë limitin për të cilin nuk aplikohen taksat, ju nuk do të paguani asnjë taksë mbi të ardhurat.

Nëse jeni i vetëpunësuar (punoni për veten tuaj), ju duhet të regjistroheni në HM Të Ardhurat dhe Dogana. Kthimi i taksave plotësohet duke përdorur një sistem vetë-vlerësimi duke paraqitur gjithë informacionin e nevojshëm dhe llogaritur fitimet tuaja etj. HM të Ardhurat dhe Dogana do t'i kontrollojnë këto të dhëna dhe do t'ju tregojnë se çfarë shume të taksave ju duhet te paguani.

Për informata të përgjithshme rreth taksave shkoni tek: www.hmrc.gov.uk

Sigurimi Kombëtar

Çdo person që është në punë, me moshë 16 deri 60 vjeç (për gratë) ose 65 (për meshkujt) mund t'i duhet që të paguajë kontributet e Sigurimit Kombëtar. Nëse jeni i punësuar ju duhet të paguani kontributet e Sigurimit Kombëtar te Klases 1. Nëse jeni i vetëpunësuar do të paguani kontributet e Sigurimit Kombëtar te Klasës 2 dhe Klasës 4.

Nëse nuk jetoni zakonisht në MB, por vini që të punoni këtu, do duhet të regjistroheni për të marrë numrin e Sigurimit Kombëtar dhe të filloni të paguani kontributet e Sigurimit Kombëtar në mënyrë të njëjtë me njerëzit që jetojnë dhe punojnë normalisht këtu. Shuma e kontributeve që do të paguani varet nga fakti nëse jeni i punësuar apo i vetëpunësuar; si dhe nga shuma që fitoni. Nëse ju paguani Sigurimin Kombëtar, atëherë ju mund të keni të drejtën e përfitimeve.

Informata të mëtejshme mund të merren në www.workingintheuk.gov.uk ose nga linja ndihmëse regjistruese: **0845 9157006**

Të drejtat për punësim

Ligji për punësim në MB mund të jetë i komplikuar. Kualifikimet për përfitime të caktuara si psh. pagesa për sëmundje dhe leje lindjeje varet nga shumë faktorë si psh. sa kohë keni që jeni banorë rezident ne MB, sa kohë jeni i punësuar dhe sa i keni paguar Sigurimit Kombëtar. Për më shumë informata rreth përfitimeve qeveritare, kontaktoni:

www.dwp.gov.uk (Kjo mund të gjendet nëse shkoni tek A tek Z e përfitimeve dhe shërbimeve, si dhe Marrëveshja për Sigurimin Shoqëror me vendet e tjera.)

Një publikim i dobishëm i “Puna në MB – Të njohësh të drejtat e tua” është në dispozicion në www.worksmart.org.uk ose telefononi: **0870 600 4882**. Materiali ofrohet në gjuhët Lituanisht, Hungarisht, Çekisht, Polonisht dhe Portugalisht.

Punëdhënësi mund t’ju bëjë zbritje nga paga nëse ato janë:

- Legalisht të kërkuara (psh taksat dhe Sigurimi Kombëtar)
- Të autorizuara nga ju sipas kontratës
- Ju keni rënë dakord me shkrim përpara zbritjes së të hollave.
- Ka gjithashtu rregulla përkatëse shtesë për ata që punojnë në shitje me pakicë.

Zyra juaj lokale për **Këshillimin e Qytetarëve (ZKQ)** mund t’ju japë gjithashtu këshilla rreth të drejtave përfituese në punësim. Detajet e kontaktimit dhe oraret e punës për zyrën tuaj më të afërt mund të merren tek organizatat që mund t’ju ndihmojnë, të cilat ndodhen në fund te kësaj broshure.

Faqja e internetit e ZKQ: www.adviceguide.org.uk

Legjislacioni i shëndetit dhe sigurisë

Nëse punësimi juaj është organizuar nëpërmjet një agjencie, atëherë ata kanë detyrime të caktuara ndaj shëndetit dhe sigurisë suaj. Ata duhet të sigurohen që nuk ju kanë futur në një punë, për të cilën ju nuk keni kualifikimet e duhura.. Punëdhënësi duhet të sigurohet që vendi juaj i punës ju siguron një mjedis të sigurt dhe trajnime përkatëse.

Ligji për Pagesë gjatë Sëmundjes (LPS) - Nëse ju jeni i sëmurë dhe mungoni në punë për më shumë se 4 ditë, atëherë mund të kualifikoheni për pagesë gjatë sëmundjes, nëse të ardhurat bruto javore janë më të larta se kufiri me i ulët i të ardhurave i sigurimit kombëtar. Kjo paguhet nga punëdhënësi. Nëse jeni i punësuar nga një agjenci dhe jeni duke paguar për Sigurimin Kombëtar, ju mund të përfitoni LPS, nëse keni qenë në detyrë gjatë kohës së sëmundjes.

Përfitimet shtetërore

Përfitimet shtetërore janë para që paguhen nga shteti për juve dhe përfshijnë mbështetjen për të ardhura, përfitime për fëmijën, pagesa për personat që kërkojnë punë, përfitimet për paaftësi të përkohshme, për strehim dhe përfitimet nga taksat e këshillit. Të drejtat për përfitime shtetërore, përbëjnë një çështje të komplikuar që varet nga kushtet individuale. Rregulli i përgjithshëm është se edhe nëse vini në Angli dhe nuk jeni duke punuar (vlen edhe për qytetarët e ZEE), ju duhet të jeni në gjendje të siguronit jetesën për veten tuaj, pa kërkuar fonde publike.

Mund të gjeni më shumë për Përfitimet Shtetërore në: www.dwp.gov.uk

Paratë dhe bankat

Kur vini në MB, do t'ju duhet normalisht të keni llogari bankare, në të cilën t'ju kalojnë pagesat nga punëdhënësi, të tërhiqni para kesh dhe të paguani të tjerët.

Për të hapur një llogari bankare, ju duhet te siguronit këto informacione:

- Provë e identitetit (pasaporta, kartën e identifikimit ose patentën kombëtare për shofer)
- Dëshmi për adresën në MB (Marrëveshja për qira ose letra e konfirmimit nga punëdhënësi juaj)
- Prova e punësimit gjithashtu shpesh kërkohet.

Zyrat Postare – Degët e Zyrës postare mund të gjenden në tërë Anglinë dhe ofrojnë linjë të gjërë të shërbimeve dhe lehtësirave:

- Shërbimet postare
- Shërbime bankare
- Pagesa e faturave
- Shërbimet e sigurimit
- Këmbimi i monedhave
- Taksat për makinën
- Kartat telefonike dhe telefoni celular top-ups.

Për detaje rreth produkteve dhe shërbimeve të Zyrave Postare, telefononi: **08457 22 33 44** ose vizitoheni faqen e internetit: **www.postoffice.co.uk**

Shërbime të tjera të dobishme:

Bashkimet/Unionet e Kreditit – ju ndihmojnë për kursime, ofrojnë lehtësira rreth huave dhe produkteve të tjera financiare. Bashkimet e Kreditit janë të lumtura t’ju japin hua të vogla antarëve me normë të ulët interesi. Unioni i kreditit është kooperativë jo fitimprurëse që drejtohet nga njerëzit lokalë për njerëzit lokalë. Për t’ju bashkuar unionit kreditues ju duhet të jetoni dhe të punoni në atë zonë. Nëse dëshironi paga juaj mund të shkojë direkt tek llogaria e unionit kreditues sepse këto mund të hapen më lehtë se disa llogari bankare.

Për ta kontaktuar unionin e kreditit në zonën tuaj:

Unioni i Kreditit në Devon Lane (mbulon Hams-in Jugor dhe Devon-in Perëndimor): **01548 857868**

Unioni Kreditit në qytetin e Plymouth: **01752 201329**

Unioni Kreditit Shpresa (Plymouth): **01752 668822**

Unioni Kreditit Fortesa (Plymouth): **01752 201183**

Teign Reach (Plough dhe Share, mbulon Teignbridge):
01626 354407

Transferimi i të Hollave me Western Union – Ky shërbim ju mundëson të dërgoni dhe të merrni para nga të afërmit dhe shokët tuaj në çdo vend të botës. Për informata të mëtejshme telefononi: **0800833 833**.

www.sendmoneyhome.org – një faqe interneti që jep informata të përgjithshme dhe burimi kryesor për këshilla dhe informata duke krahasuar linjën e produkteve në dispozicion për dërgimin e parave në gjithë botë.

Shërbimet e urgjencës



Policia

Numrat telefonik për emergjencë në MB janë 999 ose 112. Shërbimet emergjente përfshijnë Policinë, Zjarrfikësit, Ambulancën, Rojën Bregdetare. Thirrjet në shërbimet e urgjencës janë falas, edhe kur thirrni prej celularit. Ju do të lidheni me operatorin, i cili e kontrollon numrin tuaj dhe pastaj ju lidh me shërbimin që kërkon. Nëse nuk jeni të sigurtë se cili shërbim ju duhet, kërkojani këtë policisë.

Për të kontaktuar me stacionin lokal të policisë për kërkesa jo-urgjente, telefononi në: **08452 777 444**. Sajt-i: www.devon-cornwall.police.uk

Nëse nuk dini mirë Anglisht, të gjitha forcat e policisë kanë akses ndaj shërbimeve të përkthimit 24 orë çdo ditë, për 365 ditë të vitit. Pavarësisht nga gjuha që flisni, ata janë në gjendje t'ju ndihmojnë shpejt nëpërmjet lidhjes telefonike me përkthyesit. Nëse je viktimë e krimit ose thjesht kërkon ca këshilla, ky shërbim është gjithashtu në dispozicionin tuaj.

Krimi

Nëse keni kryer vepër kriminale dhe policia ju arreston, ti do të dërgohesh tek stacioni policor ku do të informohesh për të drejtat tua, të cilat përfshijnë avokatin falas, i cili ju siguron këshilla ligjorë të pavarura. Nëse shkelja është serioze, atëherë për juve në gjyq do t'ju sigurohet një përkthyes.

Është e rëndësishme t'i kuptoni disa aspekte të ligjit në Angli, sepse ato mund të kenë ndryshim nga ato të vendit tuaj. Megjithatë të gjithë ligjet janë të njëjtë për nga natyra dhe ju do ta dini çfarë është e drejtë e çfarë është e gabuar.

Alkooli – MB ka një qëndrim të zbutur ndaj konsumimit të alkoolit nga të rriturit. Ai mund të blihet çdo ditë të javës në supermarkete dhe dyqane tjera. Vendet e licensuara për të shitur alkool zakonisht janë të hapura deri vonë në mesnatë, sidomos gjatë fundjavës. Pronarët e këtyre dyqaneve janë përgjegjës për veprimet e klientëve të tyre. Është shkelje nëse ata ju shesin alkool personave të pirë. Ata zakonisht punësojnë roje te dera, për të mbajtur rregullin dhe mund të përdorin forcën për të larguar këta persona nga ndërtesa nëse shkaktojnë probleme.

Nëse konsumoni alkool në masë të tillë që të cënohet paqja në lagje, mund të kontaktohet policia dhe të përfundoni në paraburgim. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se ju kap policia në gjendje të pirë dhe të paaftë për tu kujdesur për vetveten mund të përfundoni në paraburgim.

Blerja dhe furnizimi me alkool i individëve nën moshën 18 vjeçare nga një i rritur përbën shkelje ligji. Disa të rinj grumbullohen jashtë dyqaneve që tu kërkojnë të rriturve të blejnë alkool për ta. Policia do të trajtojë rreptësisht cilindo që kapet duke blerë apo furnizuar të rinjtë me alkool.

Drejtimi i makinës nën Ndikimin e Pijes – është ilegale t'i jepni veturës në MB nën ndikimin e alkoolit. Këshilla jonë është që të mos pini gjatë drejtimit të mjetit. Kurrë mos u futni në makinë me një shofer që ka pirë alkool. Nëse jeni i pasigurt merrni një taksì ose ecni për në shtëpi. Drejtimi i makinës nën ndikimin e pijes konsiderohet shkelje e rëndë dhe po t'ju zënë do të ballafaqoheni me akuza dhe burgim.

Drogat ilegale – Kultura e drogave ilegale është i zakonshëm në disa zona në Mbretërinë e Bashkuar. Ne ju këshillojmë që të mos përziheni me asnjë lloj eksperimentimi të drogave të ndryshme ilegale. Disa tregtarë njihen për taktikat e synimit të punëtorëve migruesantë me qëllim që të krijojnë të droguar të rinj. Mos harroni se asnjë drogë e marrë në këtë mënyrë nuk është falas dhe ju do të përballeni me probleme shëndetësore dhe ligjore. Është gjithashtu ilegale të drejtoni veturën nën ndikimin e drogave.

Pirja e Duhanit – në korrik të 2007, gati në të gjitha vendet publike të mbyllura dhe vendet e punës u ndalua duhani. Kjo përfshin zyrat, fabrikat, dyqanet, pijetoret, baret, transportin publik dhe makinat e punës që përdoren nga më shumë se një person.

Thikat – ne do t'ju dekurajonim që të mos mbani ndonjë lloj thike me vete. Janë disa lloje të thikave që nuk lejohen të mbahen dhe ligjet lidhur me to janë shumë të rreptë.

Vjedhja në dyqane – Në të kaluarën, një numër i vogël i punëtorëve migruesantë janë zënë duke vjedhur artikuj në dyqane. Disa dyqane kanë metoda të sofistikuara zbuluese duke përfshirë detektive të dyqanit dhe pajisje elektronike mbikeqyrese, të maskuara dhe të dukshme. Vjedhësit raportohen në polici, arrestohen dhe paraqiten para gjyqit që të dënohen. Shumë punëdhënës do ta mendonin mirë para se të punësonin dikë që ka patur telashe me policinë.

Makinat – Është ilegale të ngisni makinë në MB nëse nuk i keni dokumentet e duhura. Nga secili drejtues mjete në rrugë kërkohet që të kenë sigurimin e MB për veturë. Juve gjithashtu ju kërkohet që të paguani taksat rrugore për makinë në formën e një Liçence Akcize, e cila tregohet në xhamin e veturës. Veturave më të vjetra se 3 vjet ju kërkohet një inspektim vjetor i quajtur MOT. Është shkelje e ligjit nëse nuk i poseidoni këto dokumente. Është gjithashtu shkelje nëse e merrni veturën pa lejen e pronarit. Nëse ziheni mund të ballafaqoheni me akuza dhe burgim.



Siguria juaj

Të gjitha

- Zbatoheni kodin e autostradës. Ky mund të blihet në librari, ose të shikohet në internet në : www.highwaycode.gov.uk

Siguria në Rrugë

- Mos harro që makinat në MB i ngasin në të majtë.
- Ecni në trotuar, nëse ka një të tillë.
- Nëse jo, ecni në anën që është përballë më trafikun.
- Nëse jeni grup i madh, ecni në rresht. Mos e bllokoni rrugën.
- Vishni rroba me ngjyrë të çelët gjatë natës ose diçka reflektuese që shihet.
- Gjithmonë kontrolloni nëse ka trafik në të dyja rrugët para se ta kaloni rrugën.
- Nëse është e mundur, përdorni vendet e shënuara për kalim.
- Kurrë mos kaloni prapa ose para autobusit. Pritni deri sa largohet, kështu që mund të shihni në të dy anët.

Drejtuesit e mjeteve

Para se ta blini veturën kërkonti këshilla nga punëdhënësi i juaj ose policia lokale.

- Ju duhet patjetër të keni patentë shoferi.
- Blini vetëm nga tregtarët apo garazhet e respektuara.
- Juve ju duhet një MOT dhe Liçenca për Akcize.
- Juve ju duhet sigurimi nga Mbretëria e Bashkuar për automjetin.
- Mos pini dhe ngisni mjetin në të njëjtën kohë.
- Drejtimi i mjetit nën ndikimin e drogave është ilegale dhe e rrezikshme.
- Është ilegale ta përdorni telefonin gjatë ngarjes.
- Ju dhe udhëtarët, patjetër duhet ta vendosni rripin e sigurimit.
- Nëse jeni të përfshirë në ndonjë aksident – JU DUHET TË NDALENI dhe ta informoni policinë. Mos harroni, policia e siguron shërbimin e përkthimit për juve.

Udhëtarët

- Asnjëherë mos hipni në makinë nëse shoferi ka pirë ose ka marrë drogë.
- Vendoseni rripin e sigurimit.

Çiklistët

Sigurohuni që biçikleta juaj është e gatshme për rrugë. Kontrolllo gomat dhe frenat para se ta përdorni. Ligji kërkon nga ju që të keni një reflektues të kuq në pjesën e pasme dhe ngjyrë qelibari në pedale. Gjithashtu nga ju kërkohet që pjesa e përparme të jetë e bardhë dhe e kontrolluar si dhe një dritë të kuqe në pjesën e pasme për përdorim gjatë errësirës dhe motit të keq.

- Sigurohuni që përdoruesit e tjerë të rrugës ju shohin pasi t'i vishni rrobat e reflektuese.
- Vendoseni helmetën e biçikletës.
- Jep sinjale të qarta kur ktheheni majtas apo djathtas.

Siguria publike

MB ka një sistem të gjerë të kamerave të lidhura direkt me policinë, që inçizojnë 24 orë në ditë në shumë qytete. Ky rrjet i kamerave i siguron policisë informata duke e ndihmuar sigurinë publike. Ata ndihmojnë rreth problemeve të shkaktuara nga pijanecët, drejtimi i makines dhe dhe parkimi. Në dëshirojmë të sigurohemi se qëndrimi juaj në Devon është i sigurtë dhe pa krime.

Siguria personale

Çdo vit, njerëzit bëhen viktime të krimit, sidomos të vjedhjeve. Nuk është ide e mirë të mbahen vlera të mëdha të hollave me vete apo në banesën tuaj. Shumë punëdhënës do t'i mbajnë paratë për ty ose do t'i transferojnë në llogari bankare. Mos mbani me vete sende me vlerë, përveçse në rastet kur nuk mund t'i shmangni. Nëse i sillni, mbajini në vend të sigurt gjatë tërë kohës.

Mos pini aq sa ta vendosni veten në rrezik. Shmangni drogat ilegale me çdo kusht. Nëse e shihni një përlëshje në zhvillim e sipër, largohuni ose thirrni policinë. Mos e merrni çështjen në duart tuaja. Policia e Devon-it është këtu për të gjithë anëtarët e publikut.

Nëse keni nevojë të flisni me policinë rreth sigurisë tuaj personale ose për ndonjë çështje kriminale, ju lutemi telefononi në stacionin policor ose flisni me Oficerin e Policisë. Kërkesat e tua do të trajtohen në mirëbesim.

Megjithëse këshillat e mësipërme mund t'ju duken të frikshme, ato janë të bazuara në përvojën e punëtorëve migrues, të cilët kanë hasur në probleme të tilla gjatë viteve të fundit në disa zona tjera. Shumica e vizitorëve në këtë zonë asnjëherë nuk kanë hasur në probleme.

Zjarri

Nëse bie zjarr në vendbanimin tuaj ose vendin e punës, mundësitë për mbijetesë varen nga kushtet. Ato janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që t'ju mbrojnë shpejtë dhe sigurt deri sa dilni jashtë. Informatat në vijim ju këshillojnë si ta parandaloni zjarrin dhe si ta mbroni veten në rast zjarri.

Lexojeni **PLANIN VEPRUES NDAJ ZJARRIT** nëse gjendet në vendbanim apo vend pune.

Ju duhet të planifikoni se si do të dilni jashtë shpejt dhe sigurt në rast zjarri.

Planifiko përpara – që të jesh i përgatitur.

- Gjejini rrugën e ikjes prej secilës dhomë në vendbanimin/vend punën tuaj (nëse jeni në katin e poshtëm si rrugë e ikjes mund të konsiderohen dritaret.)
- Mbajini këto rrugë të lira nga pengesat dhe sendet e depozituara në rrugë kalim
- Sigurohuni që çelësat janë afër bravave të dymve, dritareve, etj.
- Sigurohuni që dini si t'i thirrni Zjarrfikësit duke shtypur '999' kur je jashtë (nga kabina telefonike, celulari apo nga fqinjët).
- Si një grup diskutoni se çfarë do të bënit, nëse shpërthen zjarri ose bie alarmi i tymit gjatë natës.

Planifikoje sot – nesër mund të jetë tepër vonë.

Alarmi i Tymit

Sigurohu që vendbanimi yt ka alarm tymi. Kjo është një pajisje e dizajnuar që të bëj zhurmë nëse bie zjarri. Kjo është një pajisje që lëshon një zhurmë të fortë duke paralajmëruar për praninë e tymit dhe që ju jep kohë të ikni nga ndonjë shpërthim zjarri.

Mirëmbajtja e alarmit të tymit:

- Prekni butonin testues në alarm njëherë në javë.
- Ndërrojeni baterinë njëherë në vit ose kur jep sinjale bip.
- Vakumojeni qarkun rreth alarmit, kur t'i ndërroni bateritë.

Kurrë mos i hiqni bateritë nga alarmi. Ato janë jetësore për të funksionuar alarmi juaj.

Për çdo dyshim kontaktoni me kujdestarin e vendbanimit tuaj siç është fermeri, menaxheri i karvanit ose pronari.

Strehimi dhe akomodimi

Ekzistojnë tri lloje të akomodimeve me qira: qiradhënësit privatë, këshillat lokale dhe shoqatat strehuese. Ka pak mundësi që ju të merrni me qira strehim prej këshillit apo shoqatave, sepse zakonisht listat e pritjes janë shumë të gjata dhe shumica kërkojnë që ti të jesh banor dhe të kesh punuar në këto vend prej 12 muajsh. Për informata të mëtejshme kontaktoni zyrat e këshillit tuaj lokal.

- **Këshilli i Qytetit Plymouth: 01752 668000**
- **Këshilli i Distriktit të Hams-it Jugor: 01803 861234**
- **Këshilli i Distriktit të Teignbridge: 01626 361101**

Strehimi tek qiraxhinjtë privat

Qiraxhinjtë privatë janë në dispozicion në tërë Devon-in. Informatat rreth pronave të cilat mund të merren me qira mund të gjenden në gazeta lokale, agjencitë e pasurive të patundshme, reklamat në dyqane dhe supermarkete.

Shumë prona mund të merren me qira të mobiluara apo të pa mobiluara. Sa për orientim, zakonisht qiraja paguhet çdo muaj me paradhënie. Shumica e pronarëve ju kërkojnë kapar të cilin mund ta rimerrni në fund të periudhës së qirasë – kjo mund të jetë sa një qira mujore përkatëse. Ti duhet të dish nëse faturat e energjisë, ujit, gazit përfshihen në pagesë të qirasë. Ju gjithashtu duhet të blini një liçence televizioni, për të shikuar televizion. Këshilli juaj lokal dhe CAB mund t'ju ndihmojnë me pyetjet rreth strehimit dhe akomodimit.

Shtëpitë për Banim të Përbashkët (ShBP)

Çdo pronë e shfrytëzuar nga tre apo me shumë persona të ndryshëm, legalisht referohet si 'Shtëpitë për Banim të Përbashkët ose (ShBP). Të gjitha ShBP-të duhet të jenë të liçensuara nga këshilli lokal me qëllim që të sigurohet se i kanë standardet e sigurisë. Për sigurinë tuaj, ju nuk duhet të pranoni banimin e përbashkët nëse nuk kanë liçensë të ShBP-së.

Nëse keni problem me furnizimin me gaz, energji apo ujë ju mund të telefononi në linjën e hapur 24 orë:

Për Gaz (National Gas): 0800 111 999

Energji (Western Power): 0800 365 900

Ujë (South West Water): 0800 169 1144

Kontakte të tjera të dobishme:

Furnitori kryesor i linjave telefonike është **BT: 150**

Liçensa për televizion: 0870 241 9054 ose www.tvlicensing.co.uk

Shëndeti & mirëqenia



Trajtimet e urgjnces

Nëse ju nevojitet ndihmë emergjente, telefononi në **999** ose **112** dhe kërkojeni ambulancën. Urgjenca është ***një situatë kritike ose kërcënim*** jete e cila përfshin humbjen e vetëdijes, dhimbje të forta kraharori ose humbje gjaku.

NHS Direkt – nëse ju apo dikush që e njihni nuk është mirë dhe ka nevojë për këshilla mjekësore apo informata shëndetësore, ju me anë telefonit mund të thërrisni NHS Direkt dhe të flisni me infermieren këshilluese ose këshilluesin informues për shëndetin. NHS Direkt është në dispozicion 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. NHS Direkt mund t'ju japë informata për spitalin tuaj më të afërt, doktorin, dentistin dhe shërbimet optike. Përkthyesi është në dispozicion nëse ka nevojë – ju lutemi pyetni.

Faqja e internetit i NHS Direkt ju jep informata në disa gjuhë.

NHS Direkt: 0845 4647 ose www.nhsdirect.nhs.uk

Spitalet

Nëse ju nevojitet një trajtim urgjent në spital, ju mund ta merrni falas në çdo sektor të 'Aksidentet dhe Urgjenca' (gjithashtu të quajtura A&E ose Fatkeqësia) ose Njësia për Dëmtime të Vogla (ELV). Nëse keni rast urgjent, telefononi 999 ose 112 për t'ju marrë ambulanca. Ju nuk keni nevojë të jeni i regjistruar tek doktori, për t'i përdorur shërbimet spitalore. Sektorët e A&E në përgjithësi janë për aksidente më serioze se ELV. Spitalet e mëdha janë të lokalizuara në Torbay, Plymouth dhe Exeter, kurse ELV-të e vogla janë dispozicion në disa qendra.

Nëse jeni pranuar në spital nga doktori/GP juaj dhe jeni momentalisht duke punuar apo studiuar në Angli, kujdesi zakonisht është falas. Kjo vendoset nga spitali dhe ata mund të pyesin për provë të identitetit dhe se ku punon apo studion.

Nëse ju nevojitet të kuptoni informata të komplikuar mjekësore ose të merrni vendim për kujdesin tuaj, ju mund të kërkonit ndihmë nga përkthyesi me telefon ose personalisht duke caktuar takim. Kjo gjithashtu mund të organizohet duke telefonuar NHS Direkt.

- **Distrikti i Torbay dhe Spitali i Përgjithshëm: 01803 614567**
- **Spitali i Derriford, Plymouth: 01752 77711**
- **Royal Devon dhe Spitali Exeter: 01392 411611**

Mjekët e përgjithshëm

Mjekët e përgjithshëm (MP) janë kontakti i parë për njerëzit që kërkojnë ndihmë nga mjeku. Ata sigurojnë një linjë të gjerë të kujdesit personal dhe i referojnë pacientët tek specialistët e duhur kur ata kanë nevojë për ta. MP fillimisht bëjnë shumë punë në spitale siç është matja e tensionit të gjakut, operacione të vogla, kujdesin ndaj njerëzve me diabet, astma dhe sëmundje tjera afatgjate. Nëse ju duhet të takoheni me mjekun, ju duhet të telefononi ose të shkoni tek kirurgu për të caktuar takimin.

Nëse do rrini këtu deri 3 muaj ju mund të shkoni tek MP si rezident i përkohshëm, pa pasur nevojë të regjistroheni. Është e këshillueshme që ta merrni pasaportën me vete. Nëse do rrini këtu për më shumë se 3 muaj ju duhet të shkoni në kirurgji për tu regjistruar. Këshilloheni që ta merrni pasaportën me vete sepse mund t'ua kërkojë sportelisi.

Të gjithë pacientët i kanë shërbimet falas për Shërbimet Familjare të Planifikuara (kontraceptivet) si dhe për sëmundjet e caktuara infektive.

Për detajet rreth MP kirurgjinë më të afërt, kontaktoni **NHS Direkt: 0845 4647** ose www.nhsdirect.nhs.uk

Shërbimet dentare

Për informata rreth dentistit tuaj më të afërt, për trajtime urgjente dentare kontaktoni **Linjën ndihmëse Dentare: 0800 45805813**

Farmacitë

Farmacitë mund t'ju japin këshilla të përgjithshme shëndetësore. Nëse MP ju ka dhënë një recetë për ilaç, ju duhet të shkoni në farmaci për ta marrë ilaçin tuaj. Ka mundësi që te paguani për **secilin artikull** të shënuar në recetë.

Gazeta lokale mund t'ju japë detajet e farmacive që janë të hapura deri vonë gjatë natës.

Optikat

Dyqanet e optikës mund të gjenden në shumicën e qendrave, në rrugët kryesore dhe qendrat tregtare të qyteteve. Ju duhet të paguani për çdo test të syve si dhe për syzet e rekomanduara të përshkruara për ju në recetë.



Edukimi dhe trajnimi



Shkollat

Nëse fëmija juaj i përket moshës 5 deri 16 vjet, atëherë ligji ju kërkon që ai ose ajo patjetër të marrë edukim zakonisht duke e vijuar shkollën. Disa fëmijë edukohen në shtëpi. Edukimi nga shteti është falas. Shkollat e shtetit ndahen në filllore (mosha 5-11) dhe të mesme (11-18). Janë disa shkolla fillore në fshatra, dhe të dy llojet në shumicën e qytezave të banuara.

Për të gjetur shkollat lokale, si dhe informatat rreth shërbimeve për fëmijët nën 5 vjet, kontaktoni **Shërbimet e fëmijëve dhe Njerëzve të Rinj: 01392 382059**

Komuniteti dhe trajnimi i të rriturve

Qendrat e komunitetit nëpër tërë Devon-in ofrojnë një linjë të gjerë për lëndët baze si dhe mundësi për zhvillim personal për të gjithë banorët duke përfshirë ndihmën për folësit e gjuhëve tjera, aftësitë kompjuterike, aftësitë e të shkruarit dhe ato numerike. Ata gjithashtu ofrojnë pajisje për klubin e të rinjve, sportin dhe aktivitete të tjera edukative në natyrë.

Për më shumë informata rreth shërbimeve në vendin ku jetoni, kontaktoni

Komuniteti & Trajnimi i të Rriturve Devon: 01392 386580

Shërbimet lokale

Shërbimet e këshillit dhe numrat e kontaktit

Këshilli lokal ju siguron një linjë të gjerë shërbimesh, përfshirë mbledhjen e plehrave shtëpiake dhe riciklimin, parqet dhe hapësirat e hapura, qendrat sportive dhe të kohës së lirë, kontrollin e insekteve, mbledhjen e taksave të këshillit, etj.

Këshilli i Vendit të Devon-it dhe Qytetit të Plymouth-it gjithashtu sigurojnë shërbime në këto zona duke përfshirë edukimin, bibliotekat, drejtat për ndihmë sociale, standardet tregtare dhe kujdesi social. Informatat e mëtejshme mund të merren tek secili këshill. Detajet e kontakteve janë:

- **Këshilli i Vendit në Devon-in: 0845 155 1015 ose www.devon.gov.uk**
- **Këshilli i Qytetit në Plymouth: 01752 668000 ose www.plymouth.gov.uk**
- **Këshilli i Distriktit në Hams-in Jugor: 01803 861234 ose www.southhams.gov.uk**
- **Këshilli i Distriktit në Teignbridge: 01626 361101 ose www.teignbridge.gov.uk**

Shërbimet e bibliotekës

Në çdo zonë ka biblioteka të cilat mund t'i shfrytëzoni falas, të huazoni libra dhe t'i përdorni kompjuterët me internet. Disa shërbime mund të jenë me pagesë. Për informata të mëtejshme për bibliotekën tuaj më të afërt ju mund të kontaktoni në këta telefona:

- **Këshilli i Vendit në Devon-it: 0845 155 1001**
- **Këshilli i qytetit në Plymouth: 01752 305923**

Feja dhe besimi

MB ka një traditë të fuqishme historike të Krishtere, por sot ka plot ndjekës të besimeve të ndryshme. Ti mund të gjesh vendet e besimeve të ndryshme nëpërmjet bibliotekës apo udhëzuesit telefonik në 'Fletet e Verdha'.

Kultura dhe koha e lirë

Devoni jugor ka mijëra km me plazhe të shkëlqyera, natyrë të mrekullueshme, muzikë të larmishme dhe art skenik. Zona e Devon-it Jugor është vend fantastik për t'u kënaqur dhe kaluar kohën e lirë. Përveç plazheve, Parkut Kombëtar të Dartmor dhe vendeve me interes të veçantë historik, në qendrat kryesore ka gjithashtu edhe shumë pajisje për kohë të lirë si dhe aktivitete sportive. Secila nga qendrat kryesore ka Zyrën për Informimin e Turisteve e cila zotëron të dhëna të bollshme rreth gjërave që mund t'i bësh në këtë zonë si dhe vendet që mund t'i vizitosh.

Faqe interneti të dobishme që ndihmojnë për ta kaluar kohën e lirë:

www.somewhere-special.co.uk

www.southdevonaonb.org.uk

www.dartmoor-npa.gov.uk (Dartmoor National Park)

www.discoverdevon.com

www.visitplymouth.co.uk

Zyra për Këshillimin e Qytetarëve (ZKQ)

Zyra për Këshillimin e Qytetarëve (ZKQ) jep këshilla të besueshme, të pavarura dhe falas rreth parave, konsumatorëve, ligjit dhe çështjeve të tjera. Ata zakonisht janë shumë të zënë dhe ju duhet të telefononi përpara për të caktuar takim.

Faqja e internetit këshilluese e ZKQ është: www.adviceguide.org.uk

Të dhënat e kontaktit të zyrës lokale:

- **Hams-i Jugor: 01803 862392**
Hëne - Enjte
10:00 – 13:00 dhe 14:00 – 16:00
- **Plymouth: 0870 1264011**
Hëne - Premte
10:00 – 13:00
- **Teignbridge: 01626 203141**
Hëne, Marte, Mërkure dhe Premte
9:00 – 15:00
(I mbyllur të Enjteve)

Shërbimet e komunitetit

Nëse ju dëshironi të takoni njerëz me interesa të ngjashme, Devon ka një rrjet të mirë të vullnetarëve, grupe të komuniteteve dhe besimit, si dhe organizata që japin ndihmë, mbështetje dhe këshilla për çështje të ndryshme. Ju mund të gjeni detaje rreth grupeve nga Këshilli për Shërbime Vullnetare (KShV) ose nga organizata ngjashme.

- **KShV në Hams-in Jugor: 01803 862266**
www.southhamscvs.org.uk
- **Plymouth Community Partnership: 01752 202590**
www.pcp.org.uk
- **KShV në Teignbridge: 01626 203050**
www.teigncvs.org.uk

Vullnetarizmi

Vullnetarizmi mund të jetë një mënyrë e mrekullueshme për t'u bërë pjesë e komunitetit lokal. Mund të ketë kufizime në punën si vullnetar në MB. Nëse jeni anëtarë të BE-së nuk ka kufizime mbi punën si vullnetar – kjo liri i jepet edhe shtetasve të Islandës, Norvegjisë dhe Lihtenshtejnit. Kontaktoni Qendrën tuaj lokale Vullnetare për më shumë.

- **Qendra Vullnetare e Hams-it Jugor: 01803 862266**
- **Shoqëria Plymouth: 01752 201766**
- **Qendra Vullnetare e Teignbridge: 01626 203050**

Agjenci të tjera që mund të ndihmojnë

Iniciativa Ambër: 01752 290015

Organizatë jo-fitimprurëse që ndihmon dhe mbështet punëtorët shtegtues në Plymouth. Informatat në faqen e internetit janë në Anglisht, Polonisht, Rusisht, dhe Lituanisht. www.amber-initiatives.co.uk

Qendra Ligjore në Devon: 01752 519 794

Qendra Ligjore në Devon jep këshilla ligjore dhe e përfaqëson komunitetin në fushën e kujdesit, edukimit, strehimit dhe imigrimit.

Linja ndihmëse për MESHKUJ: 0808 801 0327

Informata, mbështetje dhe këshilla për meshkujt që kanë përjetuar dhunë vendore.

Linja Ndihmëse për Gra: 01364 644088

Dispozicion në fundjavë 10am -1pm

Linja Ndihmëse për Mbështetjen e Viktimave: 0845 676 1020

Linja Ndihmëse Kombëtare për Droga: 0800 77 66 00

Samaritanët: 08457 90 90 90

Linjë Ndihmëse mbështetje konfidenciale për të gjithë

Linja për Fëmijë: 0800 11 11

Linjë Ndihmëse mbështetje konfidenciale për personat nën moshën 18 vjeç

Ndaluesit e Krimit: 0800 555 111

Raportoni dhe zgjidheni krimin me anonimitet

Direkt konsumatorët: 08454 04 05 06

Jep këshilla të qarta dhe praktike për konsumatorë, për cilindo që blen ose ka blerë të mira/shërbime psh. për pagesa më të mëdha nga çmimet, mallra me të meta të fshehta, konfliktet, etj.

www.consumerdirect.gov.uk



Ky botim disponohet në gjuhë, si edhe në formatime të tjera si për shembull në shkronja shtypi. Ju lutemi të na kontaktoni me telefon në 01803 861234 ose me e-mail customer.services@southhams.gov.uk

Ky informacion është gjithashtu i disponueshëm në faqen tonë të internetit www.southhams.gov.uk



Ky libër ishte një projekt i përbashkët në bashkëpunim me South Hams District Council - Këshillin e Qarkut të South Hams-it, CVS-in e South Hams-it dhe është mbështetur nga CAB i South Hams-it. Është financuar nga Centrica.

Ky botim u dizajnua dhe u shtyp nga South Hams District Council